



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr. 55/2012  
Prishtinë, më 21.03. 2012, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,**  
**TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

**Munguan:** Hashim Deshishku dhe Biserka Kostiq.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Besim Zeqiri- ICO; Enis Xhemaili – KDI dhe Fjolla Uka- NDI.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.03. 2012 dhe 12.03.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike;
4. Të ndryshme.

**Kryetari**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.03. 2012 dhe 12.03.2012**

*Procesverbalet nga mbledhjet e datës 07 dhe 12.03.2012 u miratuan pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike**

**Kryetari** – Theksoj se, sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë të Projektligjeve, Komisionet funksionale shqyrtojnë në parim projektligjet. Njëkohësisht, propozoi që për këtë Projektligj, që është në shqyrtim në parim, të formohet një grup i punës.

**Visar Ymeri** – Theksoi se do të duhej të ishte në këtë mbledhje ndonjë përfaqësues i Ministrisë për të sqaruar nenin 4 pika 2, sepse në deklaratën financiare thuhet se nuk ka implikime financiare ky Projektligj, ndërsa neni i lartcekur thotë se do të themelohen njësi të reja në kuadër të komunave, që nënkuptohet se do të ketë implikime financiare.

**Lutfi Zharku** – Theksoi se e përkrah në parim këtë Projektligj, duke vlerësuar si të nevojshëm rregullimin e këtij sektori të rëndësishëm.

**Myzejene Selmani** – Theksoi se e përkrahë këtë Projektligj me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, sepse duke marrë parasysh se ky Projektligj ka qenë si pjesë e Pakos së Ahtisaarit dhe është vërejtur se gjatë zbatimit ka pasur probleme të shumta.

*Pas debatit, Komisioni nxori këtë,*

*Përfundim*

*Miratohet në parim Projektligji nr .04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.*

*Kuvendit i parashtroi këtë,*

*R e k o m a n d i m*

*1. Të miratohet në parim Projektligji nr .04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.*

*2. Arsyetimin me rekomandime do ta paraqesë, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

*Pas debatit, Komisioni nxori këtë,*

**V E N D I M**

- 1. U formua grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr .03/L-087 për ndërmarrjet publike.*
- 2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Myzejene Selmani – raportuese, Lutfi Zharku, Sala Berisha- Shala dhe Ramiz Kelmendi- anëtarë.*

3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimi, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.
4. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësine koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

#### **4. Të ndryshme**

##### **a) Lista për rentat minerare**

**Kryetari** – I njoftoi deputetët se ka ardhur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik propozim-vendimi i Qeverisë që të miratohet “Lista për rentat minerare”. Lidhur me këtë çështje propozoi që të ftohen në një takim përfaqësuesit e MZHE-së, KPMM-së dhe palët tjera në lidhje me këtë çështje.

##### **b) Projektligji nr. 04/L- 98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror**

**Kryetari** – I njoftoi deputetët lidhur me Projektligjin nr. 04/L- 98 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror. Ai tha se ka ardhur një kërkesë prej disa palëve për rishqyrtimin e amendamenteve të grupit të punës

##### **c) Projektligji nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike**

**Kryetari** – I njoftoi deputetët se kemi pranuar një kërkesë për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike nga sponsoruesi, respektivisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), nr. prot. 1215, datë 14.03.2012 dhe KK- Zyra për parashtrës nr. 04/2072/Do-888, datë 15.03.2012.

##### **d) Tryezë e rrumbullakët për të diskutuar për Ligjin për zejtarinë**

**Kryetari** – I njoftoi deputetët se një delegacion nga Oda Zejtare e Koblenc-it të Gjermanisë, do ta vizitojë Republikën e Kosovës, më dt. 02. 03 prill 2012. Me rastin e kësaj vizite, do të organizohet një tryezë e rrumbullakët në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 03.04.2012, në ora 9:45-11:30, për të diskutuar lidhur me Ligjin për zejtarinë në Kosovë. Në emër të Grupit të Grave Deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, jeni të ftuar të merrni pjesë në këtë tryezë.

*Mbledhja përfundoi në orën 12:00*

##### **E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Zenun Pajaziti**

-----  
**Kryetar i Komisionit**